



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr 06-38875 /23
Klinë,dt: 10/11 /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e X e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 13.10.2023, me fillim nga ora 9:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtorët dhe të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

Gjithashtu, theksoi se përveç pikave të cilat janë për shqyrtim në rend të ditës, të futen si pika edhe dy kërkesa nga Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit:

1. Propozim-vendimi për transfer të mjeteve financiare,
2. Propozim-vendimi për ndarje të mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve, pjesës të cilës nuk i është paguar dëmi nga vërshimet e ndodhura në vitin 2022.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara të KPF-së, të mbajtura më datë 06.09.2023 dhe 21.09.2023,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2023,
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri, fasadimi i objekteve të vjetra në qytet-renovimi i kulmit, faza III,
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për

shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri, fasadimi i objekteve të vjetra në qytet,
6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin shtator-tetor 2023,
7. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Po besoj që rendin e ditës e keni marr bashkë me material të përcjell nga shërbimi i Kuvendit, prezent jemi të gjithë. Te rendi i ditës, nëse më lejoni unë i kam edhe dy propozime të reja nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim: Propozim-vendimi për transfer të mjeteve dhe Propozim-vendimi për pagesën e dëmeve të papaguara nga vërshimet në vitin 2022. Këto janë dy propozime shtesë për të hyrë në rend të ditës.

Unë po hap debat, nëse ka dikush për rend të ditës, urdhëroni? Atëherë, kush është për?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsytimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Nuk kemi mungesa, të gjithë jemi prezent!

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara të KPF-së, të mbajtura më datë 06.09.2023 dhe 21.09.2023.

Fadil Gashi, kryesues: Po hap debat, nëse ka dikush për procesverbal?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratuan dy procesverbalet nga mbledhjet e kaluara.

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2023.

Fadil Gashi, kryesues: Tani më ju veç e keni të qartë, ne për çdo tremujor e bëjmë vlerësimin të sjellë nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të raportit financiar, të hyrat dhe shpenzimet. Nëse dëshiron drejtori një prezantim të shkurtër, pastaj kishim hapur debat, urdhëro

drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues, përshëndetje për ju anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përshëndetje për përfaqësuesin e OSB-së!

Realisht, po besoj që e keni marr materialin me kohë dhe i keni parë këto shifra që ne i kemi prezantuar për këtë raport nëntëmujor, i cili në vete bart të dhëna, shumë punë, shumë shpenzime që janë kryer gjatë kësaj periudhe. Unë nuk po lëshohem shumë me detaje, këto shifra i keni parë, i keni edhe para vetes, duke i përfshirë prej grantit qeveritar, të hyrat vetanake, të hyrat e bartura edhe grantin e donatorëve. Kështu që, është me rëndësi me ju thënë edhe me ju falënderuar për aprovimin e buxhetit që e kemi bërë për këtë seancën e kaluar për vitin 2024, që është një buxhet bukur i prezantuar mirë dhe në të njëjtën kohë, vet aprovimi me shumicë absolute të votave, do të thotë se ka qenë buxhet i shpërndarë mirë.

Vlen të thuhet para se me hyrë në shifra, si informatë me jua dhënë ju, se ditën e enjte kur ne kemi udhëtuar për Turqi, një delegacion i Drejtorisë së Financave, ka qenë një takim në nivel të Kosovës, ku është debatuar çështja e të hyrave vetanake dhe ndoshta s'ka qenë hiç keq me thënë se jemi komuna e parë në Kosovë që kemi realizuar më së shumti të hyra vetanake në kuadër të planifikimeve dhe, dmth javën që shkoj, ne e kemi tejkaluar buxhetin vjetor të planifikimit të hyrave vetanake.

Planifikimi ka qenë 1.337.000,00 në ditën e premte që ka shkuar, dmth sot një javë e kemi pasur, të hyrat vetanake 1.357.000,00 dmth jemi më lart sesa planifikimi vjetor, tash krejt kjo periudhë dmth për të hyrat vetanake për vitin 2024, granti qeveritar ka qenë 11.685.922,00; të hyrat vetanake 1.373.000,00 euro; të hyrat e bartura 1.254.000,00 euro; granti i donatorëve 31.000,00 euro; ky grant i donatorëve ka mbetur ende i pashfrytëzuar sepse kanë qenë paratë që janë vënë në emër të vërshimeve që i kemi pasur, ky 31 mijë eurosh dhe duhet me këqyr fondin se çka më tutje mund të veprojmë, është granti i donatorit të jashtëm 18.341.000,00 euro; dhe granti i jashtëm ose granti i performancës që quhet, është 426.739,00 euro. Dmth këto janë në buxhetin total për vitin 2023, 14.793.483,00 euro. Ky buxhet është shpenzuar në kuadër të kategorive të caktuara, unë ndoshta nuk po hyj më në detaje me thënë, po vlen me u theksuar se buxheti në këtë vit është shpenzuar jashtëzakonisht më lart sesa buxheti i vitit të kaluar. Në shifra është 63.44 % në total buxheti i shpenzuar, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka qenë 43.15% që dmth mbi 20% jemi më lart të shpenzimeve nëntëmujore krahasuar me vitin e kaluar. Këto dihet, janë shërbime dhe mallra, komunalë, subvencione, dhe kapitale. Në kapitale jemi pak më ulët sesa në përqindjen e shpenzimeve tjera, jemi diku te 42% por po besoj që janë shumë punë duke u kryer edhe këtë muaji edhe muajin e ardhshëm jam bukur i bindur që ne i afrohem përqindjes se duhet me pasur si performancë që mbi 75% . Kështu që, unë me këtë angazhim edhe të drejtorisë por edhe të ekzekutivit, jam jashtëzakonisht i kënaqur me këtë punë që është bërë deri këtu, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor, unë po hap debat, nëse ka dikush rreth raportit, urdhëroni? Po, Azdren?

Azdren Ramadani: Faleminderit, kryesues! Ne si komitet pajtohemi të raportohet për kuvend, kështu që, e shpall të arsyeshme lirisht, ka shpenzime, ka nga pak, po ne e përkrahim.

Fadil Gashi, kryesues: Çka më bëri përshtypje se e kemi pasur gjithmonë si vërejtje; këtë vit janë rritur shpenzimet e karburanteve, tash 10.000,00 janë më pak shpenzime me krahasuar me periudhën e vitit të kaluar. Po, Tunë Deda?

Tunë Deda: Përshëndetje, kryesues, drejtor, përfaqësuesin e OSB-së dhe gjithë të pranishmit! Faleminderit shumë, drejtor, që na informove se të hyrat vetanake janë realizuar dhe janë tejkaluar, kjo lë për të kuptuar se qytetarët kanë fituar besimin te qeverisja e mirë dhe e paguajnë tatimin se ata e dinë që kthehen në investime, e atë të shpenzimeve që ishin për dreka e darka, këto i arsyetoj, se gjithmonë aty ku punohet, aty edhe shpenzohet. Nuk është ndonjë kiamet, punoni më shumë, shpenzoni më shumë është mënyra më e mirë e mundshme. Por, dashtë Zoti edhe ky buxhet se ka mbetur për investime kapitale ta realizoni komplet, krejt çka është e mundshme dhe kryesisht kërkoj që gjatë punimeve me qenë shumë më të kujdesshëm, mos me u pranuar punët nëse nuk kryhen në mënyrë të rregullt, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Tunë! Unë kësaj pjesës së Asdrenit ja kisha shtuar te telefonat me një rekomandim tonë, që mirë ka qenë telefoninë mobile “Valën” me e ndërruar, me kthyer në “Ipko”, se po ka shumë pengesa edhe te punëtorët e shërbimit civil edhe të personelit arsimor.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Nuk është puna veç te shpenzimet, po është edhe te pamundësia e komunikimit, po ka shumë probleme.

Fadil Gashi, kryesues: Ndoshta ekzekutivi duhet me marr edhe si rekomandim, le ta ngrehim si shqetësim edhe të KPF-së edhe me u kthyer në “Ipko”. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar janar-shtator 2023, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që raporti të kalojë për shqyrtim në kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri, fasadimi i objekteve të vjetra në qytet-renovimi i kulmit, faza III.

Fadil Gashi, kryesues: Urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Po, kryesues, në një tërësi kërkesë janë 7.000,00 euro që janë planifikuar, që ne duhet me i bartur si mjete për menaxhim të këtij projekti, edhe ju i keni parë atje që punët veç janë duke u përfunduar edhe është obligim i yni që tash e mbas çdo bartje që bëhet, sa do e vogël që është, duhet edhe përmes kuvendit. Pra, çdo bartje duhet me ardhur dhe m'u realizuar përmes kuvendit, kështu që, kjo bartje është në vlerë 7.000,00 euro për fasadim dhe renovim kulmit të atij objekti.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor, tani është e çartë ku merren edhe ku orientohen këto 7.000,00 euro edhe arsyeshmëria se pse! A ka dikush?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për renovimin e kulmit, të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri, fasadimi i objekteve të vjetra në qytet.

Fadil Gashi, kryesues: Edhe kjo pothuajse është e njëjta, por me finesa të vogla të ndryshimeve edhe vlera është prej 5.000,00 euro. A ka nevojë ndonjë arsyeshmëri tjetër? Atëherë, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për fasadimin e objekteve të vjetra në qytet, të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve, pjesës të cilës nuk i është paguar dëmi nga vërshimet e ndodhura në vitin 2022.

Fadil Gashi, kryesues: Ju e dini se ne kemi vendim prej kuvendit, duke u bazuar në raport të komisionit se e ka bërë vlerësimin e dëmeve në terren. Vendimi i kuvendit ka qenë në ndarje të 86.000,00 euro, është fjala për vitin 2022, një pjesë ka qenë, tash është fjala shtesat, vendimi ka pasur për obligim ndarjen lineare prej këtyre 86.000,00 euro sipas vlerësimit të komisionit. Ndarja lineare ka nënkuptuar sipas kërkesës duke i përfshirë për secilin që është i kategorizuar në dëmet e vlerësuara prej komisionit. Para se me ja dhënë fjalën, ne e kemi tash edhe një kërkesë, por kjo ka me u përcjell për kuvendin, kërkesë e re që i bashkohet kësaj të vjetrës, që është vlera e kësaj kërkesës për pagesë. Nëse ju kujtohet, ne e kemi debatuar në kuvend, që disa kategori kanë mbetur jashtë edhe komisioni pastaj me vonesë i ka marr i ka futur edhe ato kategori, por nuk janë trajtuar, dhe m'u trajtuar edhe ato kategori, shuma po del diku 4.240,00 euro. Dmth ky

30% m'u kompensuar edhe te ta, por nëse kalon edhe kjo prej komitetit, ne duhet me shkuar në kuvend duke e miratuar edhe listën e kësaj të resë. Po deri në kuvend, tash është kërkesë e KPF-së edhe e imja, edhe e juaja po besoj, duke ju bashkuar edhe një kërkesë e kemi edhe më herët prej Zaferit, që deri në kuvend vjen lista e pagesës që është bërë për pjesën e parë, edhe në kuvend shkojmë edhe me këto tjerat edhe i kompletojmë si pagesa sipas vendimit edhe sipas punës që e kemi marr ne në kuvend. Drejtor, urdhëro?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Dmth për sqarim:

Këto obligime që kanë mbetur të porealizuara, një pjesë është për shkak të mungesës së dokumentacionit që palët nuk i kanë sjell edhe i kanë sjell shumë me vonesë; edhe e dyta është pjesa e listës rezervë që e patëm votuar në kuvend dhe që edhe ajo ka mbetur pa u përmbushur, kështu që, ne tash i kemi kompletuar të dyjat dhe i kemi sjell për seancë, që në total dmth njëra e ka dëmin 14.140,00 euro dhe tjetra e ka dmth diku 4.000,00 euro mbesin prej kësaj edhe pjesës tjetër që janë 7 familje, janë diku 10.000,00 euro, që në total nuk e mbërrin 15.000,00 euroshin që ne e kemi në obligimet për me i regjistruar familjet e dëmtuara. Fjala është për vërshimet e para, këtë e dini, para vitit të ri, edhe ne po duam me qenë korrekt edhe insistimi i kryetarit ishte që këto obligime me i kryer, dhe për seancë e kompletojmë listën edhe të paguar edhe listën e familjeve që kanë mbetur për pa u paguar obligimet.

Fadil Gashi, kryesues: Po, urdhëro, Tunë?

Tunë Deda: Po, kryesues, drejtor, faleminderit për informacionet! Edhe unë pajtohem që të ju kryhet pagesa krejt çka është e mundshme familjeve të dëmtuara, po e kam edhe një kërkesë; që ju të angazhoheni për vërshimet e dyta që janë bërë, të angazhoheni e të kërkonin nga qeveria me premtime që kanë bërë, t'i marrin qytetarët ato para që ju kanë premtuar, se me të vërtetë ka qenë një dëmtim shumë i madh i bizneseve, i shtëpive dhe prej qeverisë më duket sa kam informacion ende askush s'është kompensuar. Çka është më keq, ka informacione që ndoshta nuk e di sa janë të sakta, por ka informacione se komunat tjera janë kompensuar. Po flas me fjalët çka i kam dëgjuar unë, e ajo nëse ka ndodhur është shumë keq, por nëse s'ka marr askush, me u angazhuar që t'i marrin të gjithë, kaq!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, a ka dikush tjetër? Nëse s'ka, edhe njëherë, mbetet që me na sjell listat e pagesës, mbetet që m'u bërë ky ndryshimi i parë që ka ardhur prej drejtorisë, po në këtë pjesën e dytë tash po rritet shuma, po shkon deri në 15.000 euro si e tha edhe drejtori. Krejt kjo çka po debatojmë është për 15.000,00 euroshin, shtohen diku edhe 4.000,00 euro prej kësaj që e kemi marr me të parën, edhe me shkuar për seancë. Po, urdhëro, Mendehie?

Mendehie Duraku: Faleminderit, kryesues, përshëndetje për të gjithë! Unë desha ta pyes drejtorin për ata persona të cilët nuk janë në listë, çka kanë pasur ata që nuk i kanë përmbushur kriteret, me m'treguar pak a shumë se çka është nevojitur që ata nuk i kanë mbushur kriteret? Siç the më herët, që ka disa që nuk i kanë mbushur kriteret dhe s'kanë përfituar, faleminderit!

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, Mendehie! Kriteret me mosplotësim të

dokumentacionit dallojnë, në listë për vlerësime të dëmeve ka qenë komisioni dhe lista e komisionit që ka ardhur te ne, ajo është në pjesën kisha me thënë 90% është paguar, është realizuar. Por, ka mbetur një pjesë e listës prej 7 vetëve, që ta zëmë “Central Parku” ka qenë më shumë i dëmtuar i ka marr 2.000,00 veç si ekonomi familjare, a si biznes është i dëmtuar 22.000,00 euro, dmth e ka pjesën shtesë, se e ka rregulluar dokumentacionin ai, se nuk e ka pasur të rregulluar, ose disa të Uksahitëve, dy familje janë që kanë pasur dëme të mëdha dhe ai pronari që është dëmtuar ka pak probleme shëndetësore dhe s’ka mundur të vij, djalin e ka pasur jashtë, kur ka ardhur djali me vonesë, tani është plotësuar dokumentacioni, dmth janë çështje teknike, jo të kritereve, se dëmet i ka vlerësuar komisioni, paraprakisht.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush tjetër? Po, Mendehie?

Mendehie Duraku: Nëse e di drejtori, desha ta pyes se më ka rastisur njëherë të takohem me pronarin e restorant “Bistricës” edhe fatkeqësisht më ka thënë që unë nuk po mundem me aplikuar, në Grabanicë që është. Aty vërtet ka pasur vërshime në atë kohë edhe thjesht desha ta di: a je në dijeni, a ka përfituar ai njeri, edhe pse unë e shoh listën kur të na sjellësh në seancë, po thash nëse e din, a ka përfituar, a jo?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Më duket, tash nëse mund të jem krejt i qartë, restorant “Bistrica” jam bukur i sigurt që ka përfituar, nëse s’ka mundur të përfitojë si biznes për shkak të mungesës së dokumentacionit, që ata e kanë një formular që duhet me dërguar në ministri, për me u regjistruar si furnitor, por besoj si ekonomi familjare është i kompensuar, por e sjellim listën në seancë edhe i këqyrim.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? Atëherë, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për ndarje të mjeteve financiare për kompensimin e një pjese të dëmit nga vërshimet e vitit 2022, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 7. Propozim-vendimi për transfer të mjeteve financiare.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush për këtë pjesë, nëse s’ka, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për transfer të mjeteve financiare, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa, për muajin shtator-tetor 2023.

Kërkesa 1.

Kërkesë nga Shoqata e Gjahtarëve "Dukagjini" Klinë, kërkojnë mbështetje financiare për rrethimin e rezervatit, pasi që siç theksojnë, bëjnë kultivimin e kafshëve të egra në rezervatin i cili gjendet në zonën e fshatit Dollc, shuma e kërkuar nga shoqata është 3.980,00 euro.

Fadil Gashi, kryesues: Unë si fillim po them se për mua është e arsyeshme kjo ose po të vinte drejtori i Bujqësisë na kishte ndihmuar, sepse s'di statusin a e kanë të rregulluar ata. Urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Kryesues, unë kisha thënë që le të merret Azdreni pak me këtë punë se e ka vëllain anëtar të kryesisë në shoqatën e gjahtarëve edhe ta sqaron këtë punë.

Fadil Gashi, kryesues: E thërrasim edhe drejtorin e Bujqësisë, a bën kështu?

Tunë Deda: Kryesues, nëse nuk e kanë sjell raportin e shpenzimeve, unë nuk jam me ju ndarë pa e parë raportin, le ta sjellin njëherë raportin e parë, ku i kanë quar ato mjete, pastaj këqyrim.

Fadil Gashi, kryesues: Nëse pajtohet komiteti, ne po e lëmë një takim të përbashkët, e thërrasim edhe drejtorin e Bujqësisë. Unë e di që i kanë disa obligime edhe me ministri, se ata janë themeluar me vendim të këtij kuvendi, por tani këta nuk e kanë përsëritur më edhe e kanë humbur hapin, për këtë i kanë pasur disa telashe, i sqarojmë edhe këto, edhe çështjet administrative qysh i kanë edhe të regjistrimit. A po pajtoheni kështu, ne, Drejtoria e Bujqësisë, shoqata, edhe me i definuar çështjet kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Shoqata e Gjahtarëve "Dukagjini" Klinë, me 7 vota PËR, rekomandoi që parashtruesit të kërkesës t'i dërgohet ftesë për takim që të bisedohet çështja rreth kërkesës së parashtruar për mbështetje financiare dhe funksionimit të rezervatit në fjalë.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Arjana Banushaj, e cila kërkon mbështetje financiare, pasi që vuan nga një sëmundje e rënd nga viti 2020, thekson se njëherë ka marr ndihmë nga komuna financiarisht por që me përkeqësimin e gjendjes shëndetësore, rriten shpenzimet dhe paraqitet nevoja për kërkesë të ndihmës financiare.

Fadil Gashi, kryesues: Ndoshta ne është mirë të ulemi bashkë me ekzekutivin edhe me parë pak më ndryshe këtë situatë. Asnjë rast nuk është që ja ndajnë ndër 10.000,00 euro, ne ndoshta është mirë me e lënë hapur këtë kërkesë, me biseduar krejt, me kryetarin e me drejtorin edhe pastaj nëse duhet me ndërhyrë edhe kuvendi, me i shikuar të gjitha mundësitë se a kemi mundësi ne me bërë një fond. Po, urdhëro, Tunë ?

Tunë Deda: Po, kryesues, kjo që po thoni ju është e mirë, por duhet ne m'u angazhuar si komunë edhe me kërkuar nga qeveria, se gjitha qeveritë që kanë qenë pas lufte, asnjë gjë s'kanë bërë për sigurimin shëndetësor të njeriut. Duhet me ja kushtëzuar, çdo person me paguar sigurimin shëndetësor, bile sidomos ata që janë në marrëdhënie pune, përndryshe zgjidhje nuk ka në këtë mënyrë, se aq shumë ka raste, sa krejt buxheti i komunës me hyrë, gjitha investimet kapitale e krejt, nuk ka me ju dal. Për atë po them; është mirë me apeluar, me dal si kuvend, me kërkuar nga kuvendi i Kosovës me zbatuar, me vënë Ligjin e Sigurimeve Shëndetësore, se asnjë shtet në botë nuk është pa sigurime shëndetësore. Neve qeveria na obligon me siguruar veturën e jo njeriun, kjo kështu s'ka zgjidhje, kaq! E këtë rast (kërkesë) propozoj me e dërguar te zyra e kryetarit.

Fadil Gashi, kryesues: Tash unë mora informacion se e njëjta kërkesë qenka edhe në zyre të kryetarit, urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Mandatin e kaluar e patëm krijuar një lloj standardi për këtë kategori të sëmundjeve, edhe ne të gjithë e dimë, po ata që kanë qenë pjesë e mandatit të kaluar e patën vlerësuar se krejt çka vijnë me këtë sëmundje, me kërkesën në kuvend, me jua ndarë nga 1.500,00 euro, edhe i patëm disa raste që i patëm ndarë, po për besë edhe sot nuk e di arsye pse ndërroi kjo, se nuk mundet me u trajtuar kjo sëmundje me nivelin e sëmundjeve tjera me ka 200-300 euro, se nuk e ndihmon asgjë. Ndoshta edhe 1.500,00 është pak, po prapë se prapë është një dallim, ndryshe m'i marr 500 e ndryshe 1.500,00. Kështu që, unë kryesues po e marr obligim që edhe këtë çështje me e ngreh në bord ditën e hënë edhe të shohim bashkërisht a mundemi m'i bërë 1.000, a mundemi m'i bërë 1.500,00 apo më shumë. Ta këqyrim se kryesisht këto janë nga subvencionet e zyrës së kryetarit, e nëse ka mundësi më shumë, pse jo, pse mos me i ndihmuar.

Tunë Deda: Me sa e di unë, drejtor, kjo 1.500,00 euro ka qenë për punëtorët, që janë punëtorë të punësuar të komunës, nuk ka qenë për krejt qytetarët, e për atë nuk e di që ka rast që punëtorëve të komunës nuk ju ka dhënë, që kanë bërë kërkesë e s'jua ka dhënë, por nuk ka qenë për krejt qytetarët, këtu duhet me bërë një zgjidhje për krejt qytetarët.

Fadil Gashi, kryesues: Le të jetë rekomandim i yni me u shqyrtuar në bord, le të shkojë në zyrën e kryetarit të shqyrtohet, edhe pjesa tjetër na mbetet obligim për t'i biseduar ne alternativat se çka me bërë.

Tunë Deda: Unë mendova me dal me një kërkesë prej kuvendi të Klinës në asamble me ja dërguar kuvendit të Kosovës, edhe pse ne jemi komunë e vogël, dikush duhet me filluar me ta, se çka ka ndodhur, kujt ja kanë dhënë, nuk e di! Ama, kurrfarë arsytimi, kryesues, nuk ka, mos me

implementuar sigurime shëndetësore. Nuk ka shanse të mbajë ty qeveria, disa ndihma i jep atje, por ndryshe kur unë paguaj, unë e kam edhe firmën time po edhe firma ime obligohet me paguar një pjesë për punëtorë, a jo kështu pa lidhje, se për shembull punëtorët e bankave kanë sigurime shëndetësore, e kanë bërë privat, por e kanë.

Fadil Gashi, kryesues: Krejt këtë që po e përmend ti, ne me nxjerr një deklaratë, një propozim, me nxjerr një rekomandim në kuvend dhe me jua dërguar atyre deputetëve atje. Atëherë, a po pajtohem kështu, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Arjana Banushaj për ndihmë financiare, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe të diskutohet rreth kësaj kërkesë si dhe kërkesave të tjera të parashtruara për natyrën e njëjtë.

Kërkesa 3.

Kërkesë nga Ramë Pantina, përfaqësues i banorëve të fshatit Stapanic, për kalimin fizik dhe kadastral të parcelave, përkatësisht oborreve dhe të një pjese të tokave nga komuna e Malishevës, të kalojnë në regjistrat kadastral të komunës së Klinës, duke u bazuar në Ligin për Kufijtë Administrativ të Komunave Nr.08/L-041, përkatësisht në nenin 9, nenin 10, pika C, dhe nenin 11. Fshati Stapanic, si fshat është i ndarë në dy pjesë: njëra pjesë i takon komunës së Klinës dhe një pjesë i takon komunës së Malishevës. Pjesa që i takon komunës së Klinës në komunikimin juridik, administrativ, njihet me emrin Zabërgjë, ndërsa pjesa që i takon komunës së Malishevës, njihet me emrin Kijevë. Banorët e pjesës që i takojnë komunës së Klinës me dokumentacion civil, janë banorë legjitim të komunës së Klinës, mirëpo oborret dhe shtëpitë i kanë në territorin e komunës së Malishevës. Këta banorë, gjatë realizimit të shërbimeve të tyre në komunat përkatëse po kanë vështirësi në procedurat administrative për faktin se janë me dy komunat në rrafshin administrativ civil me komunën e Klinës, ndërsa në rrafshin kadastral me komunën e Malishevës. Këta banorë kërkojnë nga të dy komunat që me mirëkuptim reciprok dhe në konsultim me organet tjera shtetërore përkatëse, të vendosin lidhur me kërkesën e tyre që të ju aprovojnë këtë kërkesë dhe këtyre banorëve të ju lejohet kalimi nga njëra komunë në tjetrën, nga komuna e Malishevës të kalojnë në komunën e Klinës, pasi që ky fshat është i ndarë në dysh, njëra pjesë administrohet nga komuna e Malishevës e ndërsa pjesa tjetër administrohet nga komuna e Klinës. Me rastin e pranimit të kësaj kërkesë nga ana e banorëve, kërkojmë nga komuna e Klinës dhe ajo e Malishevës që në një afat të arsyeshëm të marrin në konsideratë këtë kërkesë dhe të ju drejtohen organeve tjera shtetërore përkatëse, që këtyre banorëve të këtij lokaliteti të ju kthehet një përgjigje.

Fadil Gashi, kryesues: Shtëpinë e ka në parcelë të komunës, oborri i del në parcelë në Malishevë, unë po mundohem me zbërthyer se qashtu i kanë pronat.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Ose është me dokumentacion i Klinës, por pronën komplet e ka të Malishevës.

Fadil Gashi, kryesues: Edhe kjo është, këta po kërkojnë sipas Ligjit për Kufijtë Administrativ të komunës, me filluar këto procedura që me bërë bartjen prej komunës së Malishevës në komunë të Klinës, të parcelave që këta banorë janë banorë të Klinës. Tash unë nuk kam tjetër zgjidhje, pos ne si komitet me kërkuar prej Zyrës Ligjore edhe Drejtorisë për Kadastër, nuk kemi tjetër adresë ne, tjetër zgjidhje nuk kemi, veç me orientuar në Zyre të Kryetarit, në Kadastër edhe Zyre Ligjore. Urdhëro, Tunë?

Tunë Deda: Po më duket si e çuditshme kjo kërkesë, se ata nëse e kanë shtëpinë, truallin në pronë të Malishevës është bukur zor me bart, me sjell këndeje, se ata veç i takojnë komunës së Malishevës, ajo ashtu është e ndarë, po thotë shtëpinë, truallin e kanë me komunë të Malishevës, edhe këta kanë mbetur banorë të Klinës.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Nuk është veç çështja se ata kanë mbetur me komunë të Klinës, ata janë me dokumentacion banorë të Klinës, obligimet, tatimin në pronë e krejt i kryejnë në Klinë, është më serioze kjo.

Tunë Deda: Tatimin në pronë s'është i obliguar me kryer në Klinë, ai tatimin në pronë duhet me kryer në Malishevë.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Po është banor i Klinës, në Prishtinë me qenë, nëse je banor i Klinës e ke obligim ta paguash këtu.

Fadil Gashi, kryesues: Banorët e pjesës që i takon komunës së Klinës me dokumentacion civil janë banorë legjitim të komunës së Klinës, mirëpo oborret dhe shtëpitë i kanë në territorin e komunës së Malishevës. Ju e dini, ne e kemi pasur telashe edhe rrugën kur e kemi asfaltuar, se jemi banorë të Klinës, por rruga ka qenë parcelë e komunës së Malishevës. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Ram Pantina, përfaqësues i banorëve të fshatit Stapanic, për kalim kadastral të parcelave të cilat janë me komunën e Malishevës, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit, Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi si dhe në Zyrën Ligjore.

Pika 9. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush? Po, Tunë Deda?

Tunë Deda: E kam një shqetësim të qytetarëve të Klinës, që është edhe shqetësim i juaj dhe i të gjithëve, qentë endacakë. Besoni është rrezik fëmija me shkuar në shkollë, unë udhëtoj nganjëherë këmbë në Deiq, më beso, më vijnë nganjëherë 10-15 qenë dhe vet edhe pse jam i rritur e kam bukur vështirësi m'i kaluar deri t'i kaloj ata, edhe është mirë m'i këqyr mundësinë, me parë çka mundet m'u bërë, se më i vlefshëm është një fëmijë sesa një qen.

Nëse ju kujtohet, kryesues, me kërkesë tonë disa herë, para 10 viteve, ju pat lejuar komunës së Klinës dhe komunës së Podujevës m'i eliminuar qentë dhe u pat bërë eliminimi i tyre. Po nëse bëhet eliminimi vetëm në një komunë, ata po i bien prej aty në komunë tonë, edhe send nuk u mor vesh ajo punë. Ka qenë punë 2-3 javë, një muaji që ka funksionuar, nuk e ke atë të drejtë edhe s'guxon as me menduar atë veprim, se s'lejojnë.

E shpreha si shqetësim dhe po jua lë juve me vendos, ne, një seancë të kuvendit me vënë si pikë të rendit të ditës dhe me parë çka mund të bëjmë.

Fadil Gashi, kryesues: Rekomandoni ju si KPF, trajtimi i qenve endacakë, i kishim trajtuar në seancën që vjen edhe 15 minuta s'na kushtojnë asgjë ne me ngre si shqetësim, ndoshta me ngreh alarmin edhe për nivelin qendror, se ata e kanë përsipër këtë projektin e madh. Tash nuk e di qysh e kanë shtrirë në nivel të komunave, po më duket që edhe ky do të dal i dështuar se edhe ata që po i marrin m'u munduar m'i menaxhuar edhe me i familjarizuar qysh po thonë, dhe m'i sterilizuar. Nëse pajtoheni, ne mund ta vëmë si rend të ditës aty, trajtimi qenve endacakë, a jeni për? Në rregull, dikush tjetër? Atëherë, po ju falënderoj shumë!

Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që pikë e rendit të ditës për seancën rregullt e cila do të mbahet në muajin tetor, të hyjë informimi rreth trajtimit të qenve endacakë.

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

Monika Palushi

